



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E PROKURORIT TE PËRGJITHSHËM

U R D H Ë R

Nr. 88 DATË 25. 04. 2007

PËR

**NJË NDRYSHIM NË URDHURIN NR. 291, DATË 21. 10. 2004 "PËR
FUNKSIONIMIN E PROKURORISË PËR KRIME TË RËNDA DHE
MARRËDHËNIET E SAJ ME PROKURORITË E TJERA DHE ME POLICINË
GJYQËSORE"**

Me synim, për të qartësuar kuptimin dhe zbatimin e urdhrit nr. 291, datë 21. 10. 2004 "Për funksionimin e Prokurorisë për Krime të Rënda dhe marrëdhëniet e saj me prokuroritë e tjera dhe policinë gjyqësore";

Në mbështetje, të nenit 8 pika 2 e vijues të ligjit Nr. 8737 datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", si dhe të ligjit Nr. 9110 datë 24. 07. 2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave për Krime të Rënda",

URDHËROJ:

1. Në urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 291, datë 21. 10. 2004 "Për funksionimin e Prokurorisë për krime të Rënda dhe marrëdhëniet e saj me prokuroritë e tjera dhe policinë gjyqësore", pika 11 e tij ndryshohet, si më poshtë:

"11. Urdhri Nr. 227, datë 19. 12. 2003, "Për funksionimin e prokurorive për krime të rënda dhe marrëdhëniet e saj me hallkat e tjera të sistemit të prokurorisë", shfuqizohet, me përjashtim të pikës 2 të tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

THEODHORI SOLLAKU